



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 29 Mars 2021

Nr: 12

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 07, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 25.03.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 29.03.2021, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK)

OBJEKTI: Shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 07 të koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 172, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021””.

BAZA LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Ankuesi Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 07 regj, datë 25.03.2021.

Në mbledhjen e datës 29.03.2021, ora 12:30 pas relatimit të z. Ledio Braho dhe diskutimit të përfaqësuesve të koalicionit, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 07 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17 pika 3, shkronja “a” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 pika 3, shkronjat “a” e 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 07, datë 25.03.2021, të paraqitur nga koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK).
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 30.03.2021, në orën 12:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ledio BRAHO - Relator

Elvis ÇEFA - Anëtar

Elvin LAKO - Anëtar



Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

